

EMIL LAFE**PËR MARRËDHËNIET E GJUHËS LETRARE (PËRKATËSISHT
STANDARDE) SHQIPE ME DIALEKTET**

Një ditë nga fillimi i viteve '60 në zyrën tonë (sektori i gramatikës) ra fjala për rolin e dialekteve, për pasurinë gjuhësore të pambledhur të tyre, dhe prof. E. Çabej në bisedë e sipër përmendi një thënie të shkrimtarit zviceran Gottfried Keller (1819–1890): “dialektet janë gurra ku freskohet përherë gjuha letrare.”¹ Nuk e kisha dëgjuar më parë emrin e këtij shkrimtari, se në Fakultet nuk kishim studiuar asgjë për letërsinë zvicerane. U bëra kureshtar dhe, duke e kërkuar nëpër enciklopeditë, gjeta se cilësohej si një nga shkrimtarët më të mëdhenj të gjuhës gjermane të shek. XIX, ndërsa në Zvicër vlerësohej si përfaqësuesi më i shquar i letërsisë së atij vendi dhe ishte shndërruar në një lloj miti kombëtar.

Në ato vite ishte në zhvillim programi i hulumtimit të të folmeve në të gjitha krahinat dhe rrethet e vendit. Krahës grupit të dialektologëve: J. Gjinari, B. Beci, M. Çeliku, M. Totoni, në këtë punë u përfshinë edhe punonjës të tjerë të Institutit si dhe bashkëpunëtorë të jashtëm. Diskutimi i punimeve dialektologjike në sektor ishte një nga format më me përfitim të kualifikimit tonë shkencor. Dialektologjia i rrok të gjitha fushat e gjuhës dhe të detyron të jesh i informuar dhe i përgatitur në secilën: fonetikë e fonologji, morfologji, sintaksë, leksikologji, jo vetëm në gjendjen e sotme, por edhe në vështrim historik. Korpusi i madh i skicave dhe monografive dialektore përbën një nga arritjet më të mëdha të gjuhësisë sonë. Puna që bëhej këtu, shërbeu si nxitje, si shembull e si përvojë edhe për hulumtimin e të folmeve shqipe në Kosovë, në Maqedoni e në Malin e Zi. Studiuesit e atyre anëve kanë punuar me zell të veçantë dhe me arritje të rëndësishme në këtë fushë, që janë tashmë të

¹ Këtë ide ai do ta rimerrte në kumtesën e mbajtur në Kongresin e Drejtshkrimit (nëntor 1972) me formulimin e mëposhtëm: “Ligjërimi popullor me gjithë shtresat e ndryshme që e përbëjnë, me karakterin e tij të natyrshëm e të thjeshtë, është i caktuar të jetë një gurrë e gjallë ku përtërihet vazhdimisht gjuha e literaturës.” (Çabej 1973, 256). Çështjen e marrëdhënieve të gjuhës së shkrimit me ligjërimin popullor E. Çabej e ka parë më fort me syrin e historianit të gjuhës që vëzhgon ecurinë e proceseve gjuhësore dhe udhëhiqet nga prirjet që vëren. Ndryshe prej tij A. Xhuvani nisej nga vështrimi i normativistit, që përpiqet ta mbajë gjuhën brenda rregullash të caktuara, edhe kur në përdorim shfaqen prirje të tjera. Kështu, në një diskutim të vitit, duke prekur format e shumës si *doktorët*, *profesorët*, apo *profesorat*, *doktorat*, E. Çabej shprehet: “...ai dijetar nisej nga ajo se si duhej të ishte një përdorim, e unë nga kjo se si është.” (Çabej 2011–2012, 26–27).

mirënjohura. Mbledhja e materialeve për të folme të veçanta krijoi mundësi për vështrime tematike e përgjithësuese. Gjithë kjo fushatë, siç dihet, u kurorëzua me botimin e *Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe* në dy vëllime. Në të tërë këtë veprimtari prof. Jorgji Gjinari ka një meritë të madhe si për studimet e tij të shumta, ashtu edhe për punët organizative që ka përballuar me sukses.

Dihet se dialektologjia, në kuptimin e hulumtimit të të folmeve territoriale, është e orientuar t'i shërbejë më fort vështrimit historik të gjuhës dhe këtë e dëshmojnë citimet e shumta të të dhënave të dialekteve në studime diakronike. Përmendja e Gottfried Keller-it ndërkaq ka të bëjë me rolin e dialekteve për pasurimin e gjuhës letrare, veçanërisht të gjuhës së letërsisë. Atëherë dëgjoja të thuhej se mbi 2/5 e leksikut të shqipes ishin ende të pambledhura. Prof. M. Domi i jepte rëndësi zgjerimit të gjeografisë letrare (ishte koha e ardhjes së vrullshme të penave të reja në letërsinë tonë), si një rrugë e frytshme për pasurimin e leksikut të gjuhës së shkrimit, sepse shkrimtarët e rinj vetvetiu do të sillnin në letërsi fjalët dhe shprehjet e panjohura të ligjërimeve të vendlindjes. Në ditët tona zgjerimi i mëtejshëm i gjeografisë letrare, ardhja e shumë krijuesve të rinj në botën e letrave shqipe dhe shtimi i numrit të lexuesve kanë sjellë vetvetiu një osmozë të frytshme të mjeteve gjuhësore. Pasuritë leksikore e frazeologjike të të gjitha trevave derdhen në shtratin e përbashkët të shqipes standarde dhe përpunohen e rivlerësohen në veprimtarinë krijuese letrare.

Me këto desha të kujtoj se vëmendja ndaj dialekteve, vlerësimi i visareve gjuhësore të tyre, kanë qenë të përhershme në Institutin tonë. Dihet se sektori i leksikologjisë organizonte atëherë ekspedita të përvitshme, të cilat më pas u shndërruan në një aksion kombëtar për mbledhjen e fjalës nga goja e popullit. Këto pasuri që u mblodhën dhe arritën të përpunoheshin sipas rregullave të kartotekës, shërbyen mjaft për pasurimin e fjalësit të FGjSSH (1980). Normalisht në fjalorët e gjuhëve të zhvilluara përfshihen fjalët që gjenden të dëshmuara në gjuhën e shkruar (letërsi artistike ose gjini të tjera). Por leksikografët tanë, që në FGjSh (1954), duke marrë parasysh se tradita e lëvrimit të shqipes nuk ishte aq e pasur dhe se mungonte një kartotekë e leksikut të shqipes, përfshinë në atë fjalor edhe fjalë që nuk dëshmoreshin atëherë në gjuhën e shkruar². Në parimet sipas të cilave u hartua FGjSSH (1980), u përcaktua qartë se “vlerësimi i çdo fjale e çdo shprehjeje është bërë jo duke u nisur nga burimi i saj krahinor a letrar, por sipas vlerës objektive që

² Gjatë punës si hartues i fjalëve të shkronjave **Nj** dhe **Sh** për FGjSSH (1980) kisha vënë re se për një numër fjalësh të FGjSh (1954) në Kartotekë ishte vetëm skeda e këtij fjalori dhe ndonjë shembull prej veprash të përkthyer pas botimit të FGjSh. Nga kjo kuptohet se përkthyesit e kanë shfrytëzuar mirë lëndën e këtij fjalori për të gjetur fjalët e nevojshme e të përshtatshme.

ka ajo në strukturën leksikore të gjuhës së sotme letrare kombëtare: është pasur parasysh nëse fjala i sjell apo jo ndonjë pasurim leksikut të sotëm letrar, nëse ndihmon për thellimin e pastërtisë së gjuhës letrare shqipe, nëse e zgjeron larminë e mjeteve të saj stilistikore e shprehëse etj.”³ (FGjSSH – Parathënie, IX). Kështu që marrëdhëniet e ligjëtimeve popullore me gjuhën e shkrimit a letrare në rastin tonë dalin herë të ndërmjetuara nëpërmjet shkrimtarëve, herë të drejtpërdrejta, kur p.sh. leksikografët një fjalë popullore e përfshijnë në fjalor pa e cilësuar si të tillë, duke e barazuar me fjalët me përdorim letrar.

FGjSSH mbështetet në lëndën e grumbulluar në kartotekë deri nga viti 1976, kur filloi hartimi i fjalorit dhe puna për pasurimin e kartotekës u zëvendësua me sistemimin dhe klasifikimin e materialit të mbledhur deri atëherë, për t’i shërbyer hartimit të fjalorit. Në atë kohë botimet letrare dhe të fushave të tjera në Kosovë e Maqedoni ende nuk ishin marrë hovin e viteve të mëvonshme, por dhe veprat tashmë të botuara nuk ishin vjelë në masë të gjerë për kartotekën tonë. Për këtë arsye leksiku letrar dhe popullor i atyre anëve mund të mos jetë përfshirë në përpjesëtimin e duhur në FGjSSH.

Mundësitë e shfrytëzimit të leksikut popullor për pasurimin e gjuhës letrare i kanë trajtuar në artikuj, kumtesa e punime të veçanta kolegët e fushës së leksikologjisë. Bashkë me çështje të rendit thjesht kuptimor, është trajtuar edhe përshtatja drejtshkrimore e gramatikore e fjalëve, shprehjeve dhe proverbeve me normën letrare. Në këtë mënyrë atyre u hapet rruga për një përdorim më të gjerë letrar⁴. Lidhur me çështjen e përshtatjes dëshiroj të shtoj se nuk pajtohem me mendimin se fjala dialektore duhet të ruajë formën fonetike-morfologjike të dialektit përkatës. Kur hyn në gjuhën standarde, fjala i nënshtrohet “trysnisë së sistemit” (Systemzwang) dhe kështu fjalët e gegërishtes të tipit *flakadâ-ni*, *katallâ-ni* etj., janë bërë me kohë *flakadan-i*, *kallan-i* (ashtu si *pirun-i*, *spiun-i*, *shejtan-i* etj.). Më duket e çuditshme

³ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Tiranë, 1980, f. IX (Parathënie).

⁴ Kështu është vepruar në përgjithësi në përgatitjen e lëndës për rubrikat si “Fjalë e shprehje popullore” në revistat “Studime filologjike”, “Gjuha jonë” etj., si dhe në botime të veçanta, por në shembuj janë ruajtur herë-herë edhe forma të ndryshme nga norma letrare, p.sh. Petrit Zeneli në librin “Fjalor me shprehje dhe fjalë të rralla nga Tropoja” (1999), i ka kthyer vetë sipas normës letrare fjalët dhe shprehjet në titull, me qëllim që ato të hyjnë në atë formë në një përdorim më të përgjithshëm, por në shembuj ka ruajtur forma dialektore, p.sh.: ***Kur të bëhen lendet lajthi*** – asnjëherë, kurrë. *Ajo mund të bahet kur të bahen lendat lajthi* (P. Zeneli, 196); ndërsa Avdyli Sula në librin “Fjalor fjalësh dhe shprehjesh popullore” të Malësisë së Gjakovës (2009) i ka lënë fjalët në titull pak a shumë siç i ka dëgjuar, por shpjegimin e ka dhënë sipas standardit, p.sh. ***Symëllijë*** “Me sy të vegjël e të zinj si të mëllenjës” (A. Sula, 384).

kërkesa që në standard të thuhet e të shkruhet *Gegni, gegnisht, gegnishtja* e jo *Gegëri, gegërisht, gegërishtja*, sepse fjala në standard u dashka të ruajë formën fonetike-morfologjike të dialektit burimor, edhe kur tashmë e ka bërë vendin e vet në gjuhën e shkrimit.

Ndërkohë ka dalë në dritë një material i ri shumë i pasur, që duhet shoshitur me kujdes. Dihet se ligjërimet popullore, sidomos ato të trevave periferike, kanë një numër më të madh huazimesh nga gjuhët fqinje (sllavizma e greqizma krahinore), si dhe mjaft turqizma, që jo rrallë nuk është lehtë të dallohen për shkak të ndryshimeve fonetike. Këto u vlejné historianëve të gjuhës, atyre që merren me temën “gjuhët në kontakt”, por jo pasurimit të leksikut të shqipes letrare e as të shqipes në përgjithësi. Siç e ka përmendur prof. Xhevat Lloshi në një shkrim të viteve të fundit, për këtë rrezik kishte tërhequr vëmendjen me kohë Kostandin Kristoforidhi, kur paralajmëronte më 1860 se një shqiptar, i cili do të marrë penën për të shkruar “duhet të dijë shumë gjuhë të huaja, veçanërisht greqishten e vjetër, latinishten, greqishten e re, italishten e turqishten, përndryshe ai do të bëjë gabime, duke futur fjalë dhe idioma të huaja, duke kujtuar se ato i përkasin gjuhës së tij.” Xh. Lloshi sjell rastin e “Fjalorit të gjuhës shqipe” të Mehmet Elezit (Tiranë, 2006), ku ka vërejtur një varg sllavizmash e turqizmash krahinore, krejt të panevojshme⁵.

⁵ Të shqyrtojmë kalimthi një tjetër libër të kohëve të fundit (F06): *Fjalorin e gjuhës shqipe me rreth 41.000 fjalë, që nuk gjinden në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe 1980*. Po ndalem vetëm te shkronja C. Aty kemi një trajtë “call”, që është për “sall”. Po kështu “carahosh” dhe “carahoshe” janë shqiptime të meta të fjalës turke “sarahosh”; edhe “ckrrajë” është që te F08 *skrrajë*. Nuk e kundërshtoj që ka një grusht njerëzish, ndoshta me të meta, që e shqiptojnë “call”, por po të ndiqej ky arsyetim i pasqyrimin të fjalëve në leksikografinë botërore, anglishtja dhe spanjishtja, për shembull, do të duhej të hartonin fjalorë me nga një miliard fjalë. *Sall* është turqizëm dhe shpjegimi kinse etimologjik aty është marrë në mënyrë jo korrekte nga vepra e njohur e T. Dizdarit. Më tej, autori i F06 na çon nga aty te një tjetër fjalë turke, që as T. Dizdari, me gjithë gjurmimin e tij të palodhshëm, nuk e ka ndeshur dot në gjuhën shqipe: *kapipanhë*. Në turqishten ky është një togfjalësh: *kapi pançur*. Pastaj prej kësaj *kapipanhë* na çon te “sollamadi”. As këtë nuk e ka qasur T. Dizdari. Është folja turke *salmak*, domethënë “e lëshoj të lirë”, ndërsa pjesa e dytë -*madan* në turqishten do të thotë “për diçka”. *Ckulith, cigo* janë fjalë greke. Të gjitha njësitë që vijojnë janë fjalë sllave: *capur, capurit, capuritem, capuritje, i capuritur, të capuriturit, cbih, i cbihur, cedillë, cenit, cenitje, i cenitur, cepnallkë, cernagora, cërpkë, cikaç, cikatar, i cikatarur, civlak, cmiloj, cmilohem, i cmiluar, i cmilur, coftav, cokatan, copavel, cornogore, crepujë, culahajë, culahit, culahitem, i culahitur*, si dhe variantet e tyre fonetike: *zbifem, zbifje, të zbifurit, i zbihur, zmlloj*. Po pse me sllavizma, me turqizma e me greqizma paska qenë keq gjuha shqipe për t’u “pasuruar” kështu në shekullin XXI? Libra të tillë si ky Fjalor i vitit 2006 e përmbysin

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (2006) me rreth 48 mijë fjalë vërehet një rishikim i qëndrimit ndaj krahinorizmave në krahasim me “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1980) me rreth 41 mijë fjalë. Në këtë të fundit shënim *krahin.* (fjalë, kuptim a shprehje krahinore) është përdorur rreth 1200 herë, kurse te FGjSh (2006) rreth 300 herë. Te ky fjalor kanë mbetur jashtë një varg fjalësh të shënuara si *krahin.* në FGjSSH (1980). Vetëm nga shkronja A po përmendim: *abë, abuz, ac, agë, agërshak, agosh, agullaç, agjëronjë, ajnik, akth, anames, anangas, angërduf, anjëz, apë, aplladhe, arapli, araqe, arashkë, arbër* (“fushë, rrafsh i hapët”), *arçare, arith, arkapi, arnojsë, arqitë, arsej* (“dëboj”), *arrakaçe, asobote, astanik, ashef, avermë, avermoj, avrapë, avrom, azhdë* (35 fjalë). Disa fjalë të tjera të cilësuara si krahinore në FGjSSH janë cilësuar si bisedore në FGjSh, p.sh. *adër, adërtar*, ose janë dhënë pa ndonjë shënim stilistik, si *angësht, angështoj, angështohem, angështim* etj. Kjo tregon se përfshirja ose jo e krahinorizmave në një fjalor shpjegues normativ të gjuhës shqipe, me gjithë trajtimet teorike nga leksikografët, në praktikë mbetet një çështje e ndërlikuar, ku ndikon mjaft ana subjektive, d.m.th. njohja e fjalës nga hartuesi e redaktori, përfytyrimi i tyre për vlerën dhe rolin e kësaj fjale, vështuar brenda kornizës së madhësisë së caktuar të fjalorit.

Në prozën e viteve ’50–’60, por edhe më vonë, janë përdorur jo rrallë edhe huazimet krahinore si mjete të përshtatshme për tipizimin e mjedisëve e të personazheve, për t’i dhënë ato me vërtetësi, p.sh. *cuks, imonik, kumbisem, millona, miris, molloi, rokan, rokanis, thile* (greqizma); *çepkat, esh, gllanik, gollomesh, korminë, okoll, piavicë, vërsë, vërsnik* etj. (sllavizma); *ashef, bajagi, isharet, okllai, peshtamall, shybe, zaval* etj. (turqizma). Në epokën e gjuhës letrare kombëtare të njësuar fjalët e kësaj shtrese nuk mund të vlerësohen më si dëshmi as e pasurisë, as e origjinalitetit a e ngjyresës vendore të gjuhës së shkrimtarit. Këtë e kanë ndier edhe vetë shkrimtarët. Është domethënëse për këtë qëndrimi i I. Kadaresë. Në redaktimin që ai vetë i ka bërë romanit “Kronikë në gur” (botimi i vitit 2000; botimi i parë 1971), ka zëvendësuar një varg fjalësh tipike të Gjirokastrës si dhe huazime të ndryshme me fjalë të tjera më të përgjithshme, p.sh.: *mbi pullazin e madh (mbi çatinë e madhe)*⁶, *lugu (qyngji) prej llamarine, krekoj (kapardisej), udha automobilistike (xhadeja), dyshemetë (mesoret), dritaren e këndit (e qoshkut), ndezi bishtukun (llambën), mbipetk (mushama), zgjata kryet (kokën), lumë marrok (budalla), zemërimi (inati), gjerbnin (rrufisnin) kafënë, një trazim*

shqipen me bëzhdile që nuk i përkasin asaj. Në vend të komenteve e shembujve të tjerë, dëshiroj të bëj një thirrje: Mos t’u jepen armë të gatshme në duar atyre, që kanë qëndrime antishqiptare në fushën e gjuhësisë. Duke u nisur nga ky Fjalor, që pretendon se po na pasuruaka leksikun e shqipes, mund të nxirren me dashakeqësi përfundime të vajtueshme për shqipen. (Lloshi, 2012).

⁶ Në kllapa fjala e botimit të parë.

(alarm) të brendshëm, hodha rizën (shifonin) në kokë, qelq (xham), tregu (pazari), tymtar (oxhak), thertore (kasaphanë), mishtar (kasap), ka ndodhur ndonjëherë (ka bërë vaki ...), ngarendte (vraponte), dëshmonte (depononte), shenjë (sinjal), një grua me fytyrë të mbuluar (një grua me ferexhe), kërko magjinë në trenj e kërko në qilare, kthe shtretër e përmbys arka (kërko magjinë në tavane e kërko në dysHEME, kthe dysheqe e përmbys sundukë), – Mëkat, – tha Xhezoja, – ai farë djali! (Gjynah, – tha Xhezoja, – ai goxha djalë); Në kohën kur u duk sikur ... (Tamam atëherë kur u duk sikur ...); e kështu dhe të tjera⁷. Nga kjo punë e tij si redaktor gjuhësor (ndonjëherë e diskutueshme, ndonjëherë e paqëlluar)⁸ kuptohet se shkrimtari ka përqafuar një estetikë gjuhësore të ndryshme nga e mëparshmja, se ai ka mënjanuar të huajën dhe krahinoren dhe i është drejtuar më shumë fjalës shqipe dhe fjalës me shtrirje kombëtare.

Dëshiroj ta theksoj këtë sepse jam nën përshtypjen e pakëndshme të një konference me temë “Letërsia shqipe dhe dialekti” të zhvilluar më 20 nëntor 2015, ku u la të kuptohej se, sipas organizatorëve, vendosja e standardit, ndalja e botimeve letrare në gegërishte e kanë varfëruar dhe dobësuar letërsinë shqipe, se standardi artificial i vendosur nga politika gjuhësore krijoi një letërsi të dobët, sepse shkrimtarët u detyruan të largohen nga dialekti i tyre⁹. Këtu vetvetiu del pyetja: a mos letërsia shqipe duhej të zhvillohej dhe duhet të zhvillohet edhe më tej me dy variante letrare e brenda tyre me nënvarianete? Deri kur? Fakti që metoda e realizmit socialist prodhoi edhe vepra pa ndonjë vlerë letrare, nuk ka të bëjë me veshjen gjuhësore të tyre. Sepse dihet mirëfilli që gjuha është formë e jo përmbajtje e veprës letrare. Kolë Jakova ka botuar një roman “Fshati midis ujërave” në tri vëllime nga të cilët i pari më 1972 gegërisht, dy të tjerët sipas normës letrare të sotme. Nuk besoj se ky dallim i shprehjes gjuhësore ka si pasojë edhe një dallim në nivelin letrar-artistik ndërmjet vëllimeve të veprës. Zhvillimi konvergjent i gjuhës letrare në

⁷ Puna e I. Kadaresë si redaktor i vetvetes meriton një studim të posaçëm.

⁸ Nuk duket me vend, për shembull, zëvendësimi i *kovë* me *vedër*, së pari, sepse të dyja janë sllavizma; së dyti, sepse vedra është prej druri, kova prej llamarine, kështu që vedra nuk mund të vihet në zjarr (në një rast autori për t’iu shmangur turqizmit *kazan*, ka zëvendësuar thënien *vuri kazanin në zjarr* të botimit të parë me *kishte vënë vedrën në zjarr* (!) (shih edhe shpjegimet e këtyre dy fjalëve në fjalorë).

⁹ Siç u pohua në konferencë nga organizatorët, data 20 nëntor ishte zgjedhur për ta ndërlidhur temën e saj me Kongresin e Drejtshkrimit, i cili u hap pikërisht më 20 nëntor 1972. Është një gjë e ditur se çdo gjuhë letrare a standarde mund të cilësohet si *artificiale*, sepse përfaqëson një formë të përpunuar prej shkrimtarëve e prej gjuhëtarëve të ligjërit natyror dialektor. Prandaj cilësimi si *artificial* i standardit të sanksionuar në Kongresin e Drejtshkrimit nuk tregon ndonjë dobësi të tij. Ky standard si një sistem organik i ka qëndruar më së miri provës së kohës.

periudhën e pasluftës, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, ishte i tillë, që e mundësoi pa ndonjë traumë kalimin në një formë gjuhësore të përbashkët. Këtë çështje e ka trajtuar me shembuj bindës A. Kostallari në referatin e mbajtur në Kongresin e Drejtshkrimit (Kostallari, 1973, 39–49). Duhet kuptuar qartë se ajo që u arrit me Kongresin e Drejtshkrimit, nuk ishte veçse një pikë e përealizuar e programit kulturor të Rilindjes. Prandaj është e kotë të ideologjizohet e të politizohet ajo që bëri Kongresi i Drejtshkrimit si forum mbarëkombëtar.

Me këto nuk dua të them se hulumtimet e tubimet shkencore për temën “Letërsia dhe dialekti” janë pa vend, të panevojshme. Aspak. Letërsia dialektore dhe përdorimi i dialekteve në letërsi janë fakte të njohura edhe për gjuhë letrare me tradita shumë më të hershme. Çështja është te motivimi i përdorimit të ligjërimeve dialektore, te aftësia e shkrimtarëve për të freskuar gjuhën letrare në gurrat e ligjërimit popull, ashtu siç shprehej G. Keller-i në kohën e vet¹⁰. Si letërsi dialektore mendoj se mund të quhet ajo vepër që shkruhet me synim të caktuar, zakonisht në të folmen amtare të autorit, p.sh. librat e Musine Kokalarit “Siç më thotë nënua plakë”, “Rreth vatrës”, “... sa u tunt jeta”, ose komedia “Prefekti” e Besim Levonëjs, kurse nga letërsia e Kosovës do të përmendja romanin “Heshtja e armëve” të Ramiz Kelmendit. Nuk mendoj se veprat e shkruara në variantin letrar të gegërishtes nga Rilindja e këtej duhen quajtur letërsi dialektore, meqenëse norma e sotme drejtshkrimore e morfologjike mbështet në toskërishten. Jo pak mospajtime me normën kanë edhe autorë toskë të Rilindjes, si Naim Frashëri, Çajupi, Faik Konica, Asdreni. Ata janë përpjekur të shkruajnë një shqipe letrare sa më të mirë, secili sipas mënyrës së vet, po jo një shqipe dialektore për një qëllim të caktuar.

Në këtë shkrim rreth marrëdhënieve të shqipes letrare me dialektet, kushtuar kolegut Jorgji Gjinari në 85-vjetorin e lindjes, u ndala kryesisht në fushën e leksikut (përfshirë frazeologjinë), pasi mendoj, bashkë me të tjerë, që pikërisht kjo strukturë gjuhësore është e hapur për një marrëdhënie të tillë. Në fushat e tjera si fonetika e format gramatikore është gjuha standarde ajo që ndikon për zbutjen e dhe tërheqjen e veçorive dialektore. Si dialektolog me përvojë të pasur dhe si vëzhgues i vëmendshëm i ecurisë së shtrirjes së formave letrare në përdorimin e përgjithshëm, që zhvillohet shkallë-shkallë nga njëri brez te tjetri, prof. Jorgji Gjinari e ka trajtuar disa herë dinamikën e marrëdhënieve dialekt – gjuhë letrare, duke dhënë disa përgjithësime e

¹⁰ Në konferencën “Letërsia shqipe dhe dialekti” pati disa kumtesa që trajtuan mirëfilli këtë temë, d.m.th. rrethanat dhe motivet e përdorimit të ligjërimit popullor dialektor në letërsi. Kjo temë është trajtuar edhe në veprimtari shkencore të mëparshme

rekomandime me vlerë, sidomos në kumtesat e tij të mbajtura në konferenca kushtuar gjendjes dhe zhvillimit të shqipes standarde.¹¹

BIBLIOGRAFI

- Çabej, E. (1973), *Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes*, në “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe” 20–25 nëntor 1972. I. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1973.
- Çabej, E. (2012), *Për disa çështje të morfologjisë historike të shqipes dhe të metodës shkencore* (Diskutim rreth një punimi të prof. Selman Rizës), në “Gjurmime albanologjike”, Shkencat filologjike (Prishtinë) 41–42/2011–2012, 21–51.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Tiranë, 1980.
- Kostallari, A. (1973), *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj. La langue littéraire albanaise contemporaine et les problèmes fondamentaux de son orthographe*. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1973, 186 f.
- Lloshi, Xh. (2012), *Kur fjalorët e turbullojnë shqipe*, në “Telegraf” 07.03.2012 (www.gazetatelegraf.com/speciale/13479-kur-fjaloret-e-turbullojne-shqipen.html)

¹¹ Shih: *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare shqipe me dialektet*. – “Studime filologjike”, 39(22)/1985, 1, 43–51; *Krahasime midis gjuhës letrare dhe dialekteve në sistemin morfologjik*. – “Gjuha jonë”, 7/1987, 2, 41–47; *Gjuha letrare shqipe sot përballë dialekteve*. – “Konferenca shkencore kushtuar 25-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”. Tiranë, 12 dhjetor 1997. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Shtëpia botuese “Shkenca”. Tiranë, 2000, f. 91–99; *Marrëdhëniet e sotme të dialekteve me gjuhën letrare*. – “Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit” (Aktet e konferencës shkencore – Durrës, 15–17 dhjetor 2010). Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Botimet albanologjike. Tiranë, 2011, 455–462.

SUMMARY

ON THE RELATIONS BETWEEN THE LITERARY (RESPECTIVELY STANDARD) ALBANIAN AND DIALECTS

It is well known that the basis of the actual literary Albanian were put during the National Awakening Movement (Rilindja Kombëtare, second half of the 19th century), while the standard Albanian was sanctioned in 1972 (The Albanian Congress of the Orthography, 20–25 November 1972). The Albanian assumed the function of a state language only after the Independence Declaration (28th November 1912). Therefore dhe dialectal varieties and the literary ones based on specific dialects have proved to be particularly vivacious in Albania. Given these circumstances the relations between literary (respectively standard) Albanian and dialectal speech, respectively dialectal varieties, has always represented one of the most treated topics in the Albanian linguistics. The author emphasizes the importance of the collection, evaluation and publication of the linguistic treasure of the popular varieties for the enrichment of the modern literary Albanian.

